



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 04/2026

I Mbajtur në takimin e IV-të të rregullt të Kpf-së me datën 28.05.2026, në sallën e e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e V-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt për vitin 2025;
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026
6. Propozim-Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale 678-1, 678-2 Z.K.Talinovc i Jerlive;
7. Propozim-Vendim për Këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale: 320-0, 321-2 dhe 308-6 Z.K.Talinovc i Jerlive, prona private, me pjesën e ngastrës kadastrale 459-1 Z.K.Talinovc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim-Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrës kadastrale 100-1 Z.K.Ferizaj;
9. Propozim-Vendim për aprovimin e Rregullorës për Taksa Komunale;
10. Propozim-Vendim për miratimin e plotësim-ndryshimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit të Veprimit 2024-2027;
11. Propozim-Vendim për bashkëfinancim me GLV “Bifurkacioni”;

12. Propozim-Vendim për ngritjen e tarifave, ndryshimi të Rregullores 01.Nr.124 për Parkingjet

Publike në Komunën e Ferizajt;

13. Propozim-Vendim për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e

Ferizajt;

14. Të ndryshme.

Kryesuesi i KK-së pasi e lexoi rendin e ditës të lartëcekur pyeti nëse ka dikush diqka për të shtuar lidhur me rendin e ditës dhe fjalën e morri drejtoresha e kadastrit Festina Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se e kemi një kërkesë për rishqyrtim të vendimit nr 51 i datës 31.04.2026 lidhur me kërkesën e mapl për ta rishqyrtuar këtë vendim ku duhet të jetë 2 vite mandat dhe të jetë komision ndaj të gjitha ankesave për dhënein e pronave në shfrytëzim.

Sa i përket pikës së 3 procesverbali nuk pati vëretje dhe kaloi me të gjitha votat për.

Pika e 4 raporti i auditimit për paqyrat financiare, nuk pati të interesuar për diskutim dhe kjo pikë kaloi me 9 vota për 00 për në kuvend.

Edhe pika e 5 raporti financiar nuk pati të interesuar për të diskutuar dhe u procedua për në kuvend me të gjitha votat për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6 dhe ia kaloi fjalën drejtoreshës së kadastrit Festina Hyseni e cila theksoi që kjo pikë ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshëm të parcelave të cekura në propozim dhe te pika e 8 ku kemi një kërkesë nga drejtoria e shëndetësis për gjetjen e një parcele për banim social dhe i kemi identifikuar këto parcela ku janë si pika të rendit të ditës pika 6 dhe 8, mirpo është një pronë e akp aty dhe duhet ta shpronësojmë dhe për pjesën e hekurudhës duhet me bisedu akp me infrakosin.

Visar Azemi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kam pa drejtoreshë që po bihen shpesh herë prona që po bihen për mi konvertu për banim social, a ka një plan konkret ku kan mu ndërtu ato qfar projekte qfar fonde, drejtoresha thekson që ky projekt është prej ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapsinorë.

Brahim Osmani te këto dy pika 6,8 kjo është nga 2022 ka kërku që me gjet lokacionin dhe realisht komuna ka apliku në disa prona, mirpo jau ka kthy ministria të kundërligjshëm ato prona dhe mendoj që po veprohet njejt se këto të akp-s, e mirë kishte me qenë prona komunale psh pika e 8 dhe spe di a eshte sakt talinovc muhaxherve a Ferizaj se gjeoportali pe qet atje.

Drejtoresha thekson që shikone certifikatën e pronës.

Brahim Osmani, unë sjam kundër, veq është mirë me naj pru qato kërkesa të 2022.

Drejtoresha thekson që për banim social ka kritere dhe nga takimet e fundit me ministri kanë than që ata do të na ndihmojnë në lidhje me kapn.

Kryesuesi, pasi ska tjerë për debat e hedhë në votim dhe kalon me 9 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 7 dhe ia kalon fjalën drejtoreshës Festina, e cila thekson që lidhur me këtë pikë fillimisht ka qenë një aprovim prej prona private me qenë pjesë e shpronësimit pastaj u ba vlersimi nga ministria e financave, dhe në mungesë të mjetëve financiare, pala ka ba kërkesë për këmbim dhe po e vazhdojmë me këtë procedurë.

Brahim Osmani po du një skjarim ke ba kërkesë për disa parcela, ndërsa kërkesa e personit në fjalë është vetëm për një pronë.

Drejtoresha thekson që këto mund të jenë gabime teknike sa i përket bashkangjites së materialit pasi ne i kemi shiku kërkesat dhe ne bazë të saj i kemi procedu.

Pasi ska tjerë të interesuar për këtë pikë kjo pikë kalon në kuvend me 9 vota për 00.

Kryesuesi sa i përket pikës së 8 veq u konsumuan diskutimet nëse ska dikush diqka për të diskutuar e qes direkt në votim, kjo pikë kalon me 9 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 9 dhe thekson që drejtoresha e financave është në diskutim publik me qytetar, mirpo nëse jeni të pajtimit e qojmë në kuvend e aty e diskutojmë,

Doruntina Azizi te kategorit e për taksa dua ta theksoj që deri më tani ka qenë të përfshirë edhe familjarët e veteranëve të luftës të liruar nga kjo taksë ndërsa me këtë rregullore janë të përfshirë vetëm veteranët e luftës, jo që është një tarifë shumë e lartë mirpo kanë qenë të përfshirë, dmth te veteranët jo ndërsa kategoritë tjera janë, është mirë me cekë këtë nëse është e përfshirë, megjithat mbetet me skjaru këtë pikë.

Kjo pikë kalon me 9 vota për 00 për në kuvend.

Kryesuesi e lexon pikën e 10 dhe pasi ska të interesuar për diskutim e kalojnë për kuvend me 9 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 10 dhe ia kalon fjalën drejtorit Alberton Sahiti i cili pasi përshëndeti të pranishmë thekson që është pikë e Burimit, mirpo masi ai sështë këtu po tregojë që vlera që komuna do të bashkëinvestoj është 2 mijë euro, kjo pikë kalon për kuvend me 9 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 11 dhe ia kalon fjalën drejtorit Alberton Sahti i cili thekson që kompania Ambienti njërën nga punët kryesore i ka parkingjet ata kanë ba një propozim për ti ngritur si janë të paraqitura edhe në propozim, është një rritje jo e madhe krahasuar të gjitha qmimet e operimit që kan hypur përfshirë edhe pagën minimale, tu e pas parasysh që parkingjet private janë edhe me të larta, është brenda rregullores.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit thekson që sipas arsytimit të drejtorit, i bjen që na duhet me kqyr mu barazu me privatin, na sduhet mu shty me ta se këto janë publikë.

Me këto qmime jo 50% po këto po tentohen të ngritën 100% që është e pa pranushme ne jemi kundër edhe do te jemi në kuvend mbi të gjitha arsyetimi është tepër banal, sduhet as me qu në seancë këtë pikë e nëse vjen aty normalisht që do ta kundërshtojmë.

Ne aksionart as si njohë as si kom votu ata svijnë asnjëherë.

Visar Azemi pasi përshëndeti të pranishmit thekson që në këtë pikë kisha dasht me pa një raport financiar, pasi nëse ka hyp paga minimale sështë e arsyshme mi hyp qmimet pa i pa këto analiza financiare që me dit me sakt në qfar gjenje po menagjojnë këta aksionerë.

Dhe duhet ky raport me shiku a ja vlen barra qiranë, unë po shohë këtu një diskrepancë të qmimeve të parkingjeve dhe jo kështu të operoj kushdo pa rregulla pa kriterë.

Alberton Sahiti, Visar ne kemi rregullore për parkingje, mirpo ne po falsim për rrugët kryesore edhe nënkalimin që i menagjon kompania, dhe kur ka renovime te rrugëve normalisht na ndryshojnë edhe parkingjet, atk sot ka marrë vendim për parkingjet private janë duke i kontrolluar nëpër pikat e parkingjeve private, spo dojmë mu barazu me ta po të paktën me pas përafrim.

Visar Azemi ideja e ndërmarrjes nuk është me kanë fitimprurse po me kqyr me ofru kushte te mira për qytetart dhe nëse kosto sa ka qenë i mbulon të hyrat skemi nevojë mi rrit qmimet.

Alberton Sahti thekson që në qdo fundvit do të sjellim një raport të detajuar dhe ideja sështë mi rrit qmimet veq me fitu kompania mirpo ka ardhur si rezultat i probleve që ka kompania.

Nëse ska tjerë kryesuesi e qet në votim dhe kjo pikë kalon me 9 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 13 dhe fjalën e merr Alberton Sahiti i cili thekson që në seancën e kalume e kemi kalu planin strategjik dhe ministria ka kërku me pas rregullore dhe i kemi disa ndryshime te qmimet të cilat mund ti diskutojmë në seancë, të gjitha komonat e kan rregullu ose janë në proces këtë muaj. E kemi një rritje të qmimit të mbeturinave ku besoj që është si rezultuat i qmimeve të naftës në veqanti ku për 21.000 euro rritje të koston së naftës dhe po operojmë që disa muaj, kemi ba kërkesë edhe në ministri për subvencione edhe ministria e ka rrit qmimin e grumbullimit të mbeturinave për ton, dhe në bazë të analizës kemi ardhur në përfundim që sështë një rritje shumë e lartë.

Visar Azemi qmimet në komonat e ngajshme a janë të njëjta a i din.

Alberton Sahiti thekson që nëse sgaboj, Prizreni e ka ba 9.5, malisheva 8.5, gjinali në muajin e ardhëhsm, prishtina 12, spo i di sakt mirpo përafërsisht këto janë.

Visar Azemi ti pas parasysh zhvillimet në ndërmarrje jemi kundër kësaj rregullore pasi ajo kompani ka shumë afera dhe pa marrë masa jemi kundër.

Brahim Osmani zakonisht kur vihet një rregullore e kësaj fajin ministria, kush tka than mi hap 15 vende punë kur 4 vet shkojnë në një kompjuter, ja barra financiare ja ministria.

Raporti edhe i ndërmarrjes ka tregu që ka keqmenagjim dhe ka mbi 2 milion euro borgje e qysh mi la këto borgje e hjek kryshefin edhe menagjmentin, dhe është komuna e vetme që i ka hap tender mbi 1.6 milion euro dhe nëse llogariten këto i bjen që ska në vend komunë që ka me te shtrejt qmimin per berllog, e vetmja komuna jonë i ka rritë për 1 mandat 2 her qmimet.

Alberton Sahiti pse spo ndihmon brah me shku në kmdp me than pse spo lejoni Ferizajn me pas qendër transferit pse në janar ske fol kurgja kur u rrit qmimi i ujit pse as një fjalë pse për rrymë as një fjalë u rrit 3 herë.

Këtu debati nuk dëgjohet më dhe kryesuesi e ndalon këtë debat të pa rregullt duhet të folët me rend.

Arian Imeri e merr fjalën dhe përshëndet të pranishmit dhe thekson që nuk duhet të dezinformohet pasi dallojnë pastimi i qytetit me grumbullimin e mbeturinave qështjet duhet të dallohen dhe kur u hap tenderi ka mujt pastërtia me apliku, sa i përket rritjes së qmimeve edhe Ferizaj është pjesë e Kosovës dhe shkaktari dihet që këto telashe janë të nivelit qendrorë.

Përndërisa qytetart po zgjedhin këtë qeveri normalisht që pas rritjes se qmimeve të jetesës përfshi rrymën naftën gjithqka tjetër normalisht ka mu rrit edhe berllogu.

Ejup Delolli pasi përshëndet të pranishmit thekson që kam disa pyetje për drejtorin psh disa shifra, tjetra është që kalkulimi është keq të tvsh është e kalkulume 18% e dikah me 8%, po i spjegojmë edhe në kuvend nëse ka nevojë.


Kryesuesi pasi spati tjerë për diskutim e vendos në votim dhe kalon 6 për, 2 kundër.

Kryesuesi e lexon edhe pikën shtesë shqyrtimi i vendimit nr 51 i datës 30.04.2026 pra aj ndryshimi që u propozu për komisionin e ankesave që ta ket mandatin 2 vite për të gjitha pronat kush është që të kaloj në kuvend, dhe kalon me 8 vota për 00.

Në të ndrsyhe a ka dikush pasi ska kryesuesi e shpall të mgyllur mbledhjen e kpf.

Procesmbajtësi:

Leutrim Mahmuti



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

